



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:240090

Datë: 15.05.2023

Numri i dokumentit: 04280605

C.nr.515/2013

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke shqyrtuar dhe zgjidhur kontestin nga marrëdhënia juridike të paditësit N. S., nga Prishtina, përfaqësuar me autorizim nga I. R., avokat në Prishtinë, kundër të paditurve V. K., nga Prishtina, dhe Grupi “K.” sh.p.k., me seli në Prishtinë, që të dy përfaqësuar me autorizim nga G. R., avokate në Prishtinë, me objekt të kontestit vërtetimin e shpifjes dhe fyerjes dhe kompensimin e dëmit, me vlerë të objektit të kontestit në shumën në të holla prej 100,000.00€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur më 02.05.2023, në seancë publike, në të cilën kanë prezantuar paditësi, i autorizuari i tij dhe e autorizuar e të paditurve, më datë 15.05.2023, dha këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit N. S., nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit V. K., nga Prishtina, dhe Grupi “K.” sh.p.k., me seli në Prishtinë kanë shpifur dhe fyer në dëm të paditësit me datë 23.11.2012, ku përmes shkrimit në gazetën “K. D.”, faqe 5 përmes shkrimit me titull “Arrestohen avokati B. K. dhe polici N.S.”, ku në brendësinë e saj paraqitet shpifja se “Një avokat dhe një rreshter policie “kanë bashkuar forcat” që një qytetar ta shpëtojnë nga ndjekja penale...Gazeta ka mësuar se qytetari ka raportuar rastin pasi e ka kuptuar se 7 mijë eurot e dhëna i kanë shkuar huq, duke mos ndikuar fare te një prokuror vendor i cili po e ndjek penalisht atë...Operacionin për kapjen e ish gjyqtarit B. K. dhe rreshterit policor të Njësisë së hetimeve rajonale në Prishtinë, N. S., e ka kryer Policia e EULEX-it,...Edhe zyrtari policor është i njohur për vepra kriminale. Të detyrohet i padituri V. K. nga Prishtina që paditësin ta kompensojë për dëmin jomaterial prej 30,000.00€, kurse e paditura në

shumën prej 70,000.00€. Të detyrohen të paditurit që t'i tërhiqen të gjitha shkrimet shpifëse ndaj paditësit lidhur me rasti si në pikën I të këtij dispozitivi dhe atë nga të gjitha faqet elektronike dhe të shkruara e të cilat i kanë paraqitur dhe gjenden akoma, t'i ndalin shpifjet në të ardhmen ndaj paditësit, të premtojnë se shpifja dhe fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, të bëjnë kërkim falje publike si në mediat e shkruara ashtu edhe ato elektronike, menjëherë pas marrjes së këtij aktgjykimi dhe të detyrohet të paditurit që të bëjnë publikimin e këtij aktgjykimi në të gjitha format e komunikimit mediale si atij elektronik ashtu edhe të shkruar.

II. DETYROHET paditësi që të paditurve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1,868.74€, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurve, me objekt të kontestit dhe vlerë të objektit të kontestit si në hyrje të këtij aktgjykimi, e të precizuar me parashtrësën e datës 23.02.2023, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit kanë shpifur dhe fyer në dëm të paditësit me datë 23.11.2023, ku përmes shkrimit në gazetën “K. D.”, faqe 5 përmes shkrimit me titull “Arrestohen avokati B. K. dhe polici N. S.”, ku në brendësinë e saj paraqitet shpifja se “Një avokat dhe një rreshter policie “kanë bashkuar forcat” që një qytetar ta shpëtojnë nga ndjekja penale...Gazeta ka mësuar se qytetari ka raportuar rastin pasi e ka kuptuar se 7 mijë eurot e dhëna i kanë shkuar huq, duke mos ndikuar fare te një prokuror vendor i cili po e ndjek penalisht atë...Operacionin për kapjen e ish gjyqtarit B. K. dhe rreshterit policor të Njësisë së hetimeve rajonale në Prishtinë, N. S., e ka kryer Policia e EULEX-it,...Edhe zyrtari policor është i njohur për vepra kriminale. Të detyrohet i padituri V. K. nga Prishtina që paditësin ta kompensojë për dëmin jomaterial prej 30,000.00€, kurse e paditura në shumën prej 70,000.00€. Të detyrohen të paditurit që t'i tërhiqen të gjitha shkrimet shpifëse ndaj paditësit lidhur me rasti si në pikën I të këtij dispozitivi dhe atë nga të gjitha faqet elektronike dhe të shkruara e të cilat i kanë paraqitur dhe gjenden akoma, t'i ndalin shpifjet në të ardhmen ndaj

paditësit, të premtojnë se shpifja dhe fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, të bëjnë kërkim falje publike si në mediat e shkruara ashtu edhe ato elektronike, menjëherë pas marrjes së këtij aktgjykimi dhe të detyrohet të paditurit që të bëjnë publikimin e këtij aktgjykimi në të gjitha format e komunikimit mediale si atij elektronik ashtu edhe të shkruar.

I autorizuari i paditësit, në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datën 10.05.2023, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë së precizuar, duke shtuar se baza juridike e padisë lidhur me shpifjen dhe fyerjen që të paditurit e kanë bërë ndaj paditësit buron që nga neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku përcaktohet që "Dinjiteti i njeriut është i pacënueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themeleore të njeriut", nenin 4, 5, 14, 15, 16 të Ligjit Nr. 02/L-65 Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes si dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që i referohen veprës së shpifjes dhe fyerjes.

Tutje ka shtuar se Të paditurit në publikimin e artikullit në faqen 5 të gazetës "K. D." të datës 23.11.2012 me titullin "Arrestohet avokati B. K. dhe polici N. S.", me qëllim paragjykes dhe etiketimit të të qenit fajtor paditësi, shpërndajnë fakte të pavërteta për opinionin e gjerë publik, e për të cilat fakte ata e dijnë se janë të pavërteta. Kjo pasi në publikimin e këtij "lajmi" të paditurit japin vlerësime, opinione e konstatime me qëllime të caktuara dhe të dëmshme për paditësin, e që kjo tejkalon çdo kufijë që do ta bënte publikimin e lajmit interes për opinionin publikun. Sepse publiku interesohet për të lajmet e vërteta e asesi lajme që mbështetet apo përmban shpifje dhe lajme të rreme. Lajmi në tërësi, në një shtet demokratik do të duhej të kishte kujdes edhe më të shtuar, pikërisht për shkak se paditësi ka qenë person zyrtar dhe të përmbahen nga shpifje te tilla. Sepse, shpifjet e tilla krijojnë përceptime të dëmshme edhe për Institucionin e Policisë, kur mund të krijohet opinion se brenda policisë ka njerëz me të kaluar kriminale dhe që kryejnë krime. Kjo i bën dëm edhe Institucionit dhe shtetit në vazhdimësi, nga shpifje të tilla nga mediet.

Më tej ka deklaruar se shpifjen dhe fyerjen në dëm të paditësit në publikimin e artikullit të datës 23.11.2012 në gazetën "K. D.", të paditurit e fillojnë që në hyrje të "lajmit" kur konstatojnë se "Një avokat dhe një rreshter policie "kanë bashkuar forcat" që një qytetar ta shpëtojnë nga ndjekja penale...Gazeta ka mësuar se qytetari ka raportuar rastin pasi e ka kuptuar se 7 mijë eurot e dhëna i kanë shkuar huq, duke mos ndikuar fare te një prokuror vendor i cili po e ndjek penalisht atë,...Operacionin për kapjen e ish-gjyqtarit B. K. dhe rreshterit policor të Njësisë së hetimeve rajonale në Prishtinë, N. S., e ka kryer Polica e EULEX-it,... Edhe zyrtari policor është i njohur për vepra kriminale".

Ka shtuar se të paditurit me qëllim e plasojnë lajmin në këtë mënyrë, duke e publikuar ndaj paditësit një lajm me titull dhe përshkrim bombastik, që nga publiku i gjerë të kuptohet se "paditësi/polici me avokatin kanë bashkuar forcat që një qytetar ta shpëtojnë nga ndjekja penale, se qytetari i ka dhënë 7 mijë euro dhe se paditësi "i paska" pranuar ato para që të ndikohet një prokuror vendor dhe se zyrtari policor na qenka i njohur për vepra kriminale". Shpifja e përcjellë me fyerje qëndron edhe në këtë pjesë të shkrimit, krahas tërë shkrimit të cekur, sepse gjatë operacionit të zhvilluar nga IPK-ja, paditësit nuk i është gjetur asgjë e kundërligjshme, e aq më tepër 7 mijë euro nuk kanë të bëjnë asgjë me paditësin dhe se kjo është në tërësi situatë e rremë e të paditurve, shpifje. Po ashtu, paditësi "nuk është i njohur për vepra kriminale", sepse ai që nga viti 2002 e deri në vitin 2012 kur është paraqitur fyerja dhe shpifja, asnjëherë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë rast penal apo disiplinor, as nga gjykata e as nga policia. Edhe pas fyerjes dhe shpifjes, deri në vitin 2014 sa ka shërbyer në Policinë e Kosovës kur nga i cili shërbim vullnetarësh ka dhënë dorëheqje me gradën "Toger", paditësi "nuk është i njohur për vepra kriminale".

Tutje ka deklaruar se burimin e informacionit të pretenduar nga të paditurit se kinse i janë referuar me rastin e publikimit të lajmit të datës 23 nëntor 2012 e që është "Komunikata e IPK-së" e datës 22 nëntor 2012, në fakt është deformim i atij lajmi pasi që në publikimin e IPK-së flitet vetë për "dyshimin" e assesit për konstatime apo gjykime siç janë publikuar nga të paditurit në gazetën "K. D.". Kurse, edhe përmbajtja e

komunikatës së IPK-së është ndryshe prej asaj që kanë shpifur të paditurit, të cilët e përfshijnë shkrimin me "burime të gazetës" e që ato në tërësi janë shpifje.

Më tej ka shtuar se paditësi para se të ushtronte padi ka ndërmarrë veprime me qëllim të zvogëlimit të dëmit të shkaktuar që për bazë kishin demantin ndaj shpifje dhe fyerjes të ushtruar ndaj tij përmes reagimit me "Komunikatë për Media" dhe "Njoftimin për Pushimin e Hetimeve" të cilat reagime të paditurit i konfirmojnë që i kanë pranuar përmes përgjigjes në padi e që edhe përkundër obligimit ligjor dhe moral të njëjtat reagime dhe lajme nuk i kanë publikuar në media. Edhe në përgjigjen në padi dhe në seancat gjyqësore të paditurit lidhur me publikimin e artikullit në gazetën "K. D." të datës 23 nëntor 2012 me asnjë fakt nuk kanë mundur ta dëshmojnë se kanë publikuar lajm të vërtetë që do të ishte në interesin e opinionit publik edhe pse barra e provës së publikimi të lajmeve të tilla bie mbi ta përveç fakti se kanë publikuar shpifjeve dhe fyerjeve përmes deklaratave të rrejshme dhe gjykimeve vlerësuese për qëllime të caktuara ndaj paditësit. Përkundrazi, ata kanë shpifur kur kanë deklaruar në faqen 3-pasuesi 6 i përgjigjes në padi të datës 21 shtator 2016 se nuk ka pasur reagim nga paditësi dhe se të paditurit "...asnjëherë nuk e kanë refuzuar kërkesën për publikimin e një reagimi të ndonjë pale të dëmtuar...". Nga këto të cekura i ka propozuar gjykatës që ta miratojë padinë dhe do të vendos si në kërkesëpadinë e paraqitur me shkrim ashtu edhe në precizimin e dorëzuar me shkrim në seancën e datës 23.02.2023.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë në vlerë 406.25 euro; taksën e padisë 16 euro; parashtrës/precizim 406.25 euro; përfaqësim në dy (2) seanca $2 \times 528.12 = 1.056.24$ euro, gjithsejtë 1884.74€.

E autorizuar e të paditurve në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datë 08.05.2023, ka mbesin në tërësi pranë pretendimeve të parashtruara në përgjigjet në padi dhe të gjitha argumenteve të parashtruara deri në këtë fazë gjyqësore.

Ka shtuar se paditësi, në padinë e tij vazhdon duke potencuar se në artikull do të duhej të ishte i paraqitur prezumimi i pafajësisë dhe emri i tij nuk është dashur të paraqitej (faqe 3, paragrafi 3). Ritheksojmë, e fakti që në artikull nuk është përmendur prezumimi i pafajësisë nuk i ngarkon të Paditurit me përgjegjësi për shpifje dhe fyerje, kjo për arsye se askund në Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes nuk përmendet detyrimi i gazetarëve dhe akterëve të tjerë që plasojnë lajme, që të japin epilogun gjyqësor lidhur me një rast gjyqësor e as që ta përmendin prezumimin e pafajësisë! Këto janë çështje tërësisht të ndara - ndasinë e të cilave Paditësi dështon ta kuptojë.

Tutje ka deklaruar se paditësi, insiston edhe në atë se reagimi i tij asnjëherë nuk është publikuar nga të Paditurit – duke aluduar kështu se këta të fundit kanë qëllime tendencioze ndaj të njejtit. Paditësi, do të duhej ta dinte se kur një reagim është fyes - përjashtohet publikuesi nga detyrimi për ta publikuar të njejtin. Nëse shohim reagimin e Paditësit (Komunikata për Media e datës 26 nëntor 2012) - shohim se Paditësi të Paditurin V. K. e quan “zëdhënës i kriminelëve”. Në bazë të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, publikuesi ka të drejtë që mos të reagojë ndaj reagimit kur i njejtë ndodhet para një reagimi fyes (Neni 13, paragrafi 3, nëparagrafi d). Lidhur me deklaratat kontestuese se: 2. "Një avokat dhe një rreshter policie "kanë bashkuarforcat" që një qytetar ta shpëtojnë nga ndjekja penale"... dhe 3. "Gazeta ka mësuar se qytetari ka raportuar rastin pasi e ka kuptuar se 7 mijë eurot e dhëna i kanë shkuar huq, duke mos ndikuar fare te njëprokuror vendor i cili po e ndjek penalisht atë", theksojmë se edhe këto deklaratat paraqesin një të vërtetë e cila pranohet edhe nga vetë Paditësi në Komunikatën për Media të datës 26 nëntor 2012. Paditësi, në këtë Komunikatë, ndër të tjera, ka potencuar se: "IPK-ja nuk deklaron se parat e stimuluar nga vetë ata janë gjetur tek avokati B. K., i cili ka qenë në cilësi të avokatit dhe jo të ndërmjetësit siç pretendon Inspektorati i Policisë" dhe "Unë u arrestova përmes një qytetari i cili ka më shumë vepra penale se sa që ka vjet si psh. drogë, prostitucion etj". Pra, Paditësi nuk e mohon ekzistimin e parave e as lajmërimin e rastit nga qytetari - por thekson se një gjë e tillë i është stimuluar nga IPK-ja. Ritheksojmë se të Paditurit gjatë shkrimit të artikullit janë bazuar në të dhënat e marra nga IPK. Se a kontestohen këto të dhëna të IPK-së nga Paditësi është çështje prapë tjetër, e cila nuk është objekt shqyrtimi në këtë procedurë. Lidhur me deklaratat kontestuese se: "4.

Operacionin për kapjen e ish-gjyqtarit B. K. dhe rreshterit policor të Njësisë së hetimeve rajonale në Prishtinë, N. S., e ka kryer Policia e EULEX-it....5. Edhe zyrtari policor është i njohur për vepra kriminale", prapë potencojmë se këto deklaratat janë të vërteta dhe e kemi të pa qartë se pse kontestohen. Lidhur me deklaratën e parë, është fakt se Paditësi është arrestuar nga Policia e EULEX-it. Nëse i njëjti ka vërejtje në fjalën "kapje", theksojmë se kjo fjalë është përdorur dhe vazhdon të përdoret gjithmonë në zhargonin juridik si fjalë figurative që simbolizon arrestimin e dikujt.

Më tej ka shtuar se të Paditurit kanë raportuar duke u bazuar në Deklaratën për Media të Inspektoratit Policor në lidhje me arrestimin e zyrtarit të saj, ky si raport publik pas aksionit të arrestimit nga ana e Policisë së EULEX-it dhe denoncimit nga Inspektorati Policor i Kosovës. Në artikull të Paditurit kanë cituar edhe komunikatën zyrtare të IPK-së. Në rast se Paditësi pretendon që kërkesën e tij pasurore juridike ta realizojë duke u thirrur në Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (meqenëse përfaqësuesi i tij bënë referencë në Vendimin e EULEX-it për pushimin e hetimeve), atëherë njoftojmë Paditësin se të njëjtit do të duhej ta padisin atë organ që ka inicuar procedurën penale ndaj tyre e jo të Paditurit që kanë shkruar lidhur me këtë çështje dhjetë vite më parë. Ngase, as të Paditurit nuk kanë legjitimacion real pasiv për një gjë të tillë e as Gjykata nuk ka kompetencë që të trajtoj kërkesën e tyre! Ky kaos i argumentimit ligjor ku nuk dihet fillimi e as fundi i argumentimit të bazuar në Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes na bënë të kuptojmë se nga Paditësi është duke u keqpërdorur e drejta e tij në parashtrim të padisë - duke parashtruar padi të paqarta dhe kaotike në argumentim.

Përfundimisht, ka shtuar se të Paditurit, parashtrojnë se deklaratat kontestuese në të gjithë artikujt e lartpërmendur, kanë imunitet në bazë të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Neni 9, paragrafi c), h) dhe i). Të Paditurit kanë raportuar drejtë dhe saktë në bazë të burimeve të tyre hetimeve ndaj Paditësit - i cili proces është vërtetuar në bazë të arrestimit të tij. I Padituri V. K. është gazetar, dhe e Paditura është gazeta në të cilën i Padituri V. K. ka punuar. Natyra e punës së të Paditurve është informimi i shoqërisë lidhur me të gjitha rastet të cilat prekin interesin shoqëror - në kohë dhe suaza efikase. Gazetaria ndryshe njihet edhe si pushteti i katërt - dhe roli i saj në shoqëri është jetik ngase kështu

prezervohet e drejta themelore e njeriut në marrjen e informacioneve¹. Kjo e drejtë e gazetarëve që të informojnë publikun mund të kufizohet nëse reputacioni i objektit të informimit - cenohet në njëfarë mënyre. Mirëpo, informacionet e dhëna të cilat kontestohen nga ana e Paditësve – nuk kanë qenë informacione vetëm për hir të shkrimit të një artikulli. Nuk mund të privohen gazetarët në informimin e publikut vetëm pasi që të merren Aktgjykime liruese apo dënuese ndaj dikujt! Gazetarët informojnë në vazhdimësi lidhur me të gjitha çështjet, e sidomos ato që bien nën domenin publik! Nga këto të cekura i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit.

Ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për përpilimin e Përgjigjes në padi për të Paditurin e parë - shumën prej EUR 406,25 Euro; Për përpilimin e Përgjigjes në padi për të Paditurin e dytë - shumën prej EUR 406,25 Euro; Për seancën e mbajtur me datë 23.02.2023 – shumën prej EUR 528,12; Për seancën e mbajtur me datë 02.05.2023 - shumën prej EUR 528,12. Në tërësi shumën prej EUR 1,868.74€.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova: shkrimi i gazetës K. D. i datës 23.11.2012 faqe 5, komunikata e IKP-së e datës 22.11.2012, kopja e një padie të datës 18.01.2021 në të cilin i paditur është V. K., dy linke të internetit me lajme, komunikata për media e paditësit e datës 26.11.2012, dhe njoftimi për media për pushimin e hetimeve ndaj paditësit.

Pasi që gjykata beri vlerësimin e secilës prove veç e veç, e në lidhmëni me njëra tjetrën, çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegjes, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që vërtetoi këtë gjendje faktike.

Në këtë çështje juridike nuk ishte kontestues fakti se i padituri i parë, me datën 23.11.2012 kishte shkruar një artikull në Gazetën e të paditurës së dytë, “K. D.”.

Kontestuese në këtë çështje ishte baza juridike e kërkesëpadisë, respektivisht nëse artikulli në fjalë kishte përmbajtje shpifëse dhe fyese ndaj paditësit – gjë që do të ishte bazë për kompensimin e dëmit.

Për vërtetimin e fakteve kontestuese gjykata iu ka referuar provave materiale, respektivisht artikullit kontestues të publikuar nga gazeta “K. D.” me 23.11.2012 dhe komunikatës për media të Inspektoratit Policor të Kosovës të datës 22.11.2012.

Nga artikulli i lartcekur, gjykata gjeti se i padituri i parë ka shkruar një artikull në gazetën “K. D.”, në rubrikën “a.”.

Në këtë artikull me titullin “Arrestohen avokati B. K. dhe polici N. S.”, Gjykata gjen se i padituri i parë, ka shkruar kurse e paditura e dytë publikuar një shkrim me karakter informues, lidhur me arrestimin e avokatit B. K. dhe këtu paditësit.

Tutje gjykata nga komunikata për media të Inspektoratit Policor të Kosovës të datës 22.11.2012, ka gjetur se ky institucion shtetëror ka njoftuar se ka arrestuar një avokat (B.K) dhe një rreshter policor të njësisë së hetimeve në Prishtinë (N.S), nënë dyshimin për marrje ryshfeti, dhënie e ryshfetit dhe shpërdorimi i detyrës zyrtare.

Kjo gjykatë vlerëson se, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, bazuar në provat e administruara, dhe mbi gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, kërkesëpadia e paditësit sa i përket vërtetimit të shpifjes dhe fyerjes është e pathemeltë në prova dhe ligj, për arsye se:

Me nenin 1 paragraf 1, pika a) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji nr. 02/L-65), përcaktohet se: “ Ky Ligj ka për qëllim të rregulloj përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje duke siguruar: a) Të drejtën e lirisë së shprehjes siç garantohet me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 të dt. 15 Maj 2001) dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore në Njeriut, ndërsa në pikën b), të po këtij neni,

përcaktohet se: “ Rregullat që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen të mos vënë kufij të paarsyeshëm mbi lirinë e shprehjes duke përfshirë edhe publikimin dhe diskutimin e çështjeve me interes të rëndësishëm për publikun”.

Me nenin 3, pika a) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklaratë të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër”, në pikën b), përcaktohet se: “ Fyerja nënkupton deklarin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese”, në pikën j), përcaktohet se: “ Zyrtar publik nënkupton çdo person i cili ushtron autorizime publike për një autoritet publik”, ndërsa në pikën k), të po këtij neni, përcaktohet se: “ Çështje e interesit publik nënkupton çdo çështje e cila është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë dhe mos u kufizuar në çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha degët e pushtetit, politikë, shëndetësi dhe siguri publike, zbatim të ligjit, administrim të drejtësisë, interes të konsumatorëve dhe interes shoqëror, ambient, çështje ekonomike, ushtrim të pushtetit, shkencë, art dhe kulturë”.

Me nenin 5 paragraf 1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë ligj”, ndërsa me paragrafin 4, të po këtij neni, përcaktohet se: “ Autoritetet publike ndalohen nga paraqitja e kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja. Zyrtarët publik mund të paraqesin kërkesë për kompensimin e dëmit nga shpifja ose fyerja, privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal”.

Me nenin 7 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapë materialin me qëllim të mirë, duke marr parasysh rëndësinë e

lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla ”.

Me nenin 9 paragraf 1 pika c) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Deklaratat e dhëna nuk bartin përgjegjësi në bazë të këtij ligji, nëse i padituri dëshmon se ato janë bërë në cilën do nga rrethanat në vijim: a) çdo deklaratë e bërë gjatë çdo faze të procedurave paragjyqësore, gjyqësore ose administrative, nga cilido që është përfshirë direkt në këtë procedurë, përveç rasteve kur provohet se deklarata në fjalë nuk lidhet fare me procesin gjyqësor;, ndërsa në pikën h), të po këtij neni, përcaktohet se: “ një raportim i drejtë dhe i saktë nga çdo material që përmbahet në paragrafët (a) - (g) të këtij neni;”, kurse në pikën i) të këtij neni përcaktohet se një raportim i drejtë dhe i saktë i çdo materiali që përbën një dokument zyrtar, ku statusi i këtij dokumenti arsyeton përhapjen e materialit, siç janë dokumentet zyrtarë të dala nga një hetim publik, ose nga një gjykatë ose legjislacion i huaj;.

Me nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, përcaktohet se: “ Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së opinionit dhe të shprehjes, gjë që nënkupton të drejtën për të mos u prekur për shkak të opinioneve të tij si dhe të drejtën për të kërkuar, për të marr dhe për të përhapur informata dhe ide me çfarëdo mjeti të mundshëm dhe pavarësisht nga kufijtë ”.

Me nenin 10 paragraf 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, përcaktohet se: “ Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshinë lirinë e mendimit dhe lirinë për të marr ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marr parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv ”.

Si rrjedhojë e gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë dhe kualifikimin e kësaj gjendje faktike në përputhje me të drejtën materiale, kjo gjykatë erdhi në përfundim se të paditurit nuk kanë për detyrim që paditësit t’ia kompensoj dëmin mbi bazën e shpifjes,

për shkak të informacionit shpifës ndaj personalitetit të paditësit në mënyrë publike, në shumën e gjykuar si në dispozitiv të aktgjyimit, për arsyeje se në këtë rast rezulton se të paditurit kanë dëshmuar para gjykatës se burim kryesor i informacionit për përgatitjen e artikullit “Arrestohet avokati B. K. dhe polici N. S.”, ka qenë deklaratë për media e IPK-së, e cila në përputhje me nenin 9 të LCKSHF përjashton përgjegjësinë e të paditurve. Kjo dispozitë përcakton se çfarëdo deklarate e cila rrjedhë nga një organ, e që në rastin konkret Inspektorati Policor i Kosovës është i besueshëm për publikim dhe asnjë individ apo institucion nuk është përgjegjës për publikim e një deklarate të tillë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, artikulli kontestues ka pas për qëllim të prezantojë për opinionin publik (informacion me interes publik) ekskluzivisht fakte dhe të dhëna si dhe ka cituar me përpikëri burimin e informacionit e që është IPK-ja, lidhur me rastin. Shkrimin e të paditurit të parë, kjo gjykatë e vlerëson si të atillë që i njëjti nuk është lëshuar në komente dhe vlerësime të veta, por vetëm prezantim i një informacioni të lëshuar nga një institucion shtetëror.

Për më tepër, kjo gjykatë çmon se faktet e publikuara në shkrim janë të bazuara në deklaratën për Media të IPK, i cili në cilësinë e institucionit publik, në mënyrë publike ka konfirmuar arrestimin e paditësit dhe dyshimin për veprat penale sikurse përshkruhet në shkrimin e publikuar.

Përfundimisht, kjo gjykatë vlerëson se në këtë çështje juridike civile është vërtetuar se publikimi i artikullit kontestues është mbështetur në informata të një institucioni publik, atëherë rezulton se kërkesëpadia e paditësit për vërtetimin e shpifjes është e pathemeltë në prova dhe ligj.

Për efekt të natyrës së kësaj çështje juridike, kjo gjykatë vlerëson se ky aktgjykim është në pajtim me instrumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut e që janë të zbatueshme edhe në Republikën e Kosovës, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës. Kështu, Liria e shprehjes parashihet edhe me nenin 10, të Konventës Evropiane të te Drejtave të Njeriut, që citon : se gjithkush ka të drejtën e shprehjes. Kjo e drejtë përfshin

lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë pjesë ose për të dhënë informacion ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysht kufij të shtetëror. 1. Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund të nënshtrohen disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj, dhe që, në një shoqëri demokratike, përbejnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, për integritet territorial ose për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe për parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen të dinjitetit ose të të drejtave të njeriut, për të parandaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë pushteti gjyqësorë. Lidhur me këtë, kjo gjykatë mban në vëmendje edhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim do të përdoret shkurtesa: GJEDNJ), e cila në jurisprudencën e saj në çështjen *Handyside kundër Britanisë së Madhe*, ka theksuar se liria e shprehjes është një nga shtyllat e shoqërisë demokratike, bazë për zhvillimin e saj dhe kusht për vetë realizimin e individit. Ajo nuk mund të përfshijë vetëm informacionet dhe opinionet pozitive, ose të konsiderohen si të dëmshme, apo indiferent por edhe të tilla që fyejnë, trillojnë apo janë shqetësim për shtetin ose për një grup të caktuar të shoqërisë. Të tilla janë kriteret e pluralizmit, të tolerancës dhe të hapjes, pa të cilat një shoqëri demokratike nuk mund të ekzistoj.

Me dispozitën e nenit: 452 të LPK – së, shprehimisht është përcaktuar se ‘‘Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore’’.

Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi të cilat shpenzime detyrohet paditësi që t’i kompensoj të paditurit, e që i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të palës së paditur dhe atë: për përpilimin e Përgjigjes në padi për të Paditurin e parë - shumën prej EUR 406,25 Euro; Për përpilimin e Përgjigjes në padi për të Paditurin e dytë - shumën prej EUR 406,25 Euro; Për seancën e mbajtur me datë 23.02.2023 – shumën prej EUR 528,12; Për seancën e mbajtur me datë 02.05.2023 - shumën prej EUR 528,12. Në tërësi shumën prej EUR 1,868.74, sipas

Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit: 449.2, 452.1, 453.1, 456 të LPK – së.

Përveç të cekurave si në arsyetim të këtij aktgjykimi, kjo gjykatë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera nga padia, përgjigja në padi, seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, andaj nga arsyet e theksuara me larte konform nenit 5 par.4 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, lidhur me nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.515/13, më 15.05.2023.

PËRPARIM ZEKA

GJYQTAR

UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtoj ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.